



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 07, datë 29.10.2015

PËR

DELEGIMIN E PËRGJEGJËSIVE BASHKISË TIRANË PËR SHOYRTIMIN DHE  
MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE ZHVILLIMI/NDËRTIMI TË PARASHIKUARA  
NË LISTËN NR. 3, TË VENDIMIT NR. 7, DATË 23.03.2015 TË KËSHILLIT KOMBËTAR  
TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 14/1, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, nenit 45, gërma “a” të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar, Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, si dhe Vendimit Nr.7, datë 23.03.2015 të KKT-së “Për trajtimin e disa kërkesave për leje zhvillimi/ndërtimi të depozituara pranë bashkisë Tiranë përpara hyrjes në fuqi të Vendimit Nr.1, datë 22.08.2014, të KKT-së “Për harmonizimin e instrumenteve të planifikimit vendor në funksion të ndarjes së re administrativo-territoriale”, në marrëveshje me Bashkinë Tiranë dhe me kërkesë të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Delegimin e Përgjegjësive Bashkisë Tiranë, për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për Leje Zhvillimi/Ndërtimi të parashikuara në Listën Nr. 3 të Vendimit Nr. 7, datë 23.03.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit, në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe rregullat e përcaktuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit.
2. Bashkia Tiranë si autoritet i planifikimit të botojë në Regjistrin e Integruar të Planifikimit të Territorit të gjitha projekt-aktet dhe aktet nga momenti i depozitimit të kërkesës deri në vendimin përfundimtar të saj.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**


**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**

A circular blue ink stamp from the Ministry of Urban Development in Tirana, Albania. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top, "MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN" on the sides, and "TIRANË" at the bottom. A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.

**SEKRETARE E KKT**

**LEDIA TOTA**

A circular blue ink stamp from the Agency for Urban Development of the Republic of Albania. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top, "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT" on the sides, and "MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN" at the bottom. A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.

**DREJTORE E AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

